

**Vertaling Nederlands- Albanees.**

**Dit is de vertaling Albanees van "Ramadan in tijden van corona" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Ramadan in tijden van corona".**

## **Ramazani në kohën e koronës**

Masat e marra kundër koronavirus-it ndikojnë edhe tek periudha e Ramazanit. Lexoni këtu se si ta kaloni këtë periudhë në mënyrë të sigurt.

Periudha e agjërimit vjetor, Ramazani, këtë vit do jetë nga 24 prilli deri në 24 maj. Gjatë Ramazanit myslimanët agjërojnë nga agimi deri në perëndimin e diellit. Në darkë agjërimi prishet me një iftar. Për myslimanët, Ramazani është një kohë reflektimi, uniteti dhe solidariteti. Ramazani mbyllet me Fitër Bajramin (Eid-Al Fitr).

### **Bashkia i uron myslimanëve të Gentit një Ramazan të këndshëm por edhe të sigurt.**

Nga masat e marra kundër përhapjes së koronavirus-it, Ramazani këtë vit do të zhvillohet në rrethana të vështira. Së bashku me Shoqatën e Xhamive të Gent-it (Vereniging van de Gentse Moskeeën), bashkia u bën thirrje myslimanëve të Gent-it që të respektojnë në mënyrë strikte, gjatë Ramazanit, masat e marra.

1. Lutjet bëjini në shtëpi. Xhamitë do vazhdojnë të jenë të mbyllura për publikun. Lutjet e përbashkëta (lutjet ditore, lutja e të premtes dhe lutjet e Taraweeh) do jenë të ndaluara në të gjitha shtëpitë e lutjeve.
2. Prishjen e agjërimit, iftar-in, mund ta shtroni vetëm me pjesëtarët e familjes tuaj të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi me ju. Iftar-i lejohet vetëm në banesën tuaj.
3. Mbas prishjes së agjërimit, mos dilni në rrugë për të takuar familjarë, shokë apo fqinjë. Mbani kontakt me ta në mënyra të tjera (me anë të telefon-it, smartphone-it ose mediat sociale, ...). Një shëtitje e shkurtër me pjesëtarët e familjes që jetojnë në të njëjtën shtëpi me ju, është e lejuar.
4. Shtrimi i iftar-it në xhami nuk lejohet. Xhamitë e Gent-it po shikojnë nëse mund të ofrojnë alternativa (përshembull paketa me ushqime të cilat mund të shkonin t'i merrni për konsumim në shtëpi). Më shumë informacion për këtë mund të merrni tek Shoqata e Xhamive të Gent-it ose tek përgjegjësi i xhamisë në lagjen tuaj.
5. Dyqanet ushqimore (bakalli, kasapi, dyqani i bukës, supermarket-et) janë hapur, por duhet të ndjekin rreptësisht rregullat e vlefshme. Tregtarët duhet të kujdesen që klientët të mbajnë mjaftueshëm distancë nga njëri-tjetri. Ata duhet të lejojnë vetëm një numër të kufizuar klientësh në të njëjtën kohë në dyqan. Ndihejmon dhe ju vetë për këtë. Mbani një distancë prej të paktën 1 metër e gjysëm ndaj klientëve të tjerë. Planifikojini blerjet që përpara dhe mënjaroni momentet kur ka shumë njerëz.
6. Policia ka kohë që vëzhgon rreptësisht zbatimin e masave në kuadrin e koronavirus-it. Ai që nuk i respekton rregullat, do të gjobitet.

Së bashku do të kalojmë një muaj të këndshëm Ramazani. RAMADAN MUBARAK!

### **Informacion shtesë**

#### Kontaktet

- Dienst Welzijn en Gelijke Kansen – Zyra për Mirëqënien dhe Shanset e Barabarta (Bashkia e Gent-it) – [welzijngelijkekansen@stad.gent](mailto:welzijngelijkekansen@stad.gent) – 09 267 03 00

**Vertaling Nederlands- Albanees.**

**Dit is de vertaling Albanees van "Ramadan in tijden van corona" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Ramadan in tijden van corona".**

- Vereniging van Gentse Moskeeën – Shoqata e Xhamive të Gent-it – [vzwVGM@gmail.com](mailto:vzwVGM@gmail.com) – 0485 82 42 39 (Demir Ali Köse) – 0497 33 36 06 (Abderrazak El-Omari)